



3A Bashkim familjar tek prindi/prindërit ose fëmijët me vendbanimin në Zvicër (me leje qëndrimi ose shtetësi zvicerane).

Qëllimi: Për fëmijët e mitur si dhe prindërit të cilët dëshirojnë të jetojnë tek prindi/fëmija në Zvicër të cilët kanë leje qëndrimi B,C,F ose shtetësi Zvicerane.

Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

<input type="checkbox"/> 3 formularë të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.	<input type="checkbox"/> Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga personi i cili jeton në Zvicër.
<input type="checkbox"/> Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit (pasaporta) si dhe 2 kopje.	<input type="checkbox"/> Certifikata origjinale e vendbanimit.
<input type="checkbox"/> 2 kopje të pasaportës si dhe të leje qëndrimit së prindërit/fëmijës në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Vërtetim origjinal nga gjykata si dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme se personi nuk është nën hetime
<input type="checkbox"/> Certifikata e lindjes origjinale: lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja.	<input type="checkbox"/> Në rast të ndryshimit të emrit: Kopje e vërtetuar e aktgjykimit të ndryshimit të emrit.
<input type="checkbox"/> Certifikata origjinale e martesës, e lëshuar nga shteti ku është lidhur kurora.	<input type="checkbox"/> Nëse keni lindur jashtë martese: pranimin e atësisë origjinal (vendimi i gjykatës).
<input type="checkbox"/> Për personat të cilët janë të ve: certifikata origjinale e vdekjes e bashkëshortit/-es paraprak/-e, e lëshuar nga shteti iku ka ndodhur vdekja si dhe certifikata origjinale e martesës, me vërejtje se martesa është zgjidhur.	<input type="checkbox"/> Për personat të cilët janë të shkurorëzuar: kopja e verifikuar e flete shkurorëzimit (me shënim rreth plotfuqishmërisë) si dhe certifikata e martesës së mëparshme, me vërejtje se martesa është zgjidhur.
<input type="checkbox"/> Vërtetim origjinal për të gjitha ndryshimet në librin e amzës:	
<ul style="list-style-type: none"> - Gjendja civile "beqar" përshkruhet në vërtetim me: "Nuk ka shënime". - Gjendja civile "i martuar" përshkruhet në vërtetim me: "...ka lidhur kurorë me...në..." dhe "Nuk ka shënime tjera". - Gjendja civile "i shkurorëzuar" përshkruhet në vërtetim me "Ka qene i martuar me ... me datën në ...", "Martesa me ... është shkurorëzuar me vendim të gjykatën me datën ..." dhe "Nuk ka shënime tjera". 	

→ Dokument shtesë për fëmijë

Nëse njëri prej prindërve jeton në Maqedoninë e Veriut: Ai/ajo duhet të jetë prezent gjatë dorëzimit të kërkesës të fëmijës dhe ta japë pëlqimin me shkrim që fëmija të shkojë për të jetuar në Zvicër përgjithmonë (një deklaratë nga gjykata ose nga noteri nuk pranohet). Prindi duhet të sjellë me vete letërnjoftim të vlefshëm.

INFORMATAT TË RENDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- * Të gjitha vendimet të cilat janë vetëm në gjuhë lokale duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Personi i cili jeton në Zvicër duhet të informohet drejtpërsëdrejti me zyrën kompetente të migracionit për ecurinë e procedurës.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e prindit ose fëmijës i cili banon në Zvicër.
- Terminet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet ne ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara **nuk pranohen**.



Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminimit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: pristina.visa@eda.admin.ch. Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar**.
- **Marrja e vendimit:** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër. Prindi/fëmija në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të **hënës deri të premten prej orës 8:00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.**

Vula apostile

Të gjitha certifikatat/dokumentet duhet të pajisen me vulë apostile nga gjykata e shkallës së parë (nëse nuk janë certifikata internacionale).

Pagesa

- Falas për fëmijët nën moshën 21 vjeçare për bashkim familjar tek prindi me shtetësi zvicerane ose shtetësi të EU.
- Për fëmijët që dëshirojnë të bëjnë bashkim familjar tek prindërit të shtetësisë së Maqedonisë Veriore:
 - 0 – 6 vjeç : Falas
 - 6 – 12 vjeç : 40 euro
 - +12 vjeç dhe të rriturit: 80 euro
- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.